




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/ 204

27/07/2018

Podujevë

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i datës 19.10.2017, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018, si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Podujevës, Drejtoria e Arsimit:

### PLOTËSIM I KONKURSIT

Të datës 24/07/2018, nr. 05/203, në Drejtorinë e Arsimit

#### 1. Shfmu "Ilir Konushefci" Lluga

- Një mësimdhënës të edukatës muzikore për 6 orë

Sqarim:

Kushtet dhe kriteret për këtë vend pune janë caktuar në konkursin nr. 05/203, të datës 24/07/2018

Po ashtu ju njoftojmë se është lëshuar një gabim teknik në konkursin nr. 05/203, të datës 24/07/2018, ku nuk janë cekur kushtet, kriteret dhe detyrat për pozitën punëtor teknik, të cilat do t'i paraqesim në vijim:

#### Detyrat kryesore të punës:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha mjediset e shkollës, të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës;
- Të ruaj mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujës;
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës;
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lëndëve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe sipas nevojës, t'ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës;
- Të përkujdeset për sanimin, mirëmbajtjen e inventarit të shkollës dhe për sanimin e prishjeve teknike në objektin e shkollës;
- Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

#### KUSHTET:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin bazik (të dorëzojnë dëshmi mbi kualifikimin),
- Certifikatën e lindjes,
- Dokumentin personal – letërnjoftimin ose pasaportën (kopje),
- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht,
- Të kenë shëndet të mirë,
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranohen në marrëdhënie pune, para se të lidhet kontrata)
- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra nr. 04)

u.d. drejtor

Agim Blakçori, Msc.

